

Partizani mund paster Teuten

nga Albaniassocer

E shtunë, 20 Shtator 2014 08:43



Dje u zhvilluan dy ndeshjet e para te javes se 5-te te Kategorise Superiore. Ne Qemal Stafa perballe te kuqve te Duros ishte Teuta e Hasan Likes. Pjesa e pare ishte disi e ekuilibruar por Partizani ishte gjithnje i rrezikshem duke pasur disa raste me Fazliun qe nuk arriti te shenonte. Do te vinte minuta e 39-te qe Racic te kalonte ne avantazh ekipin e kuq pas nje aksioni te insistuar te Bathes. U duk sikur goli zhblokoi edhe sulmuesin tjeter Fazliu i cili pas vetem 3 minutash dyfishoi rezultatin. Pjesen e dyte Teuta kerkoi te rekuperonte disi por pa arritur qe te rrezikonte konkretisht porten e Hoxhes. Nje episod qe mund te rihapte ndeshjen ishte faulli i Vrapit ndaj braziljanit Rafael ne hyrje te zones. Ky rast ishte shume i dyshimte sepse faulli u duk i qarte por gjyqtari nuk akordoi penallti per miqte. Aty u duk sikur mbaruan edhe shpresat e djemve te detit. Partizani administroi me qetesi rezultatin deri ne fund te 90 minuteshit.